



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8917 prot

Roskovec, më 03/10 /2022

VENDIM

NR 71 .DATË 30.09 .2022

**“PËR MIRATIM TË NISMËS PËR NDRYSHIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM
VENDOR TË BASHKISË ROSKOVEC”**

Mbështetur në autoritetin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec dhe në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika 14; ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 ”Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar neni 12 dhe neni 13, dhe VKM nr. 686, datë 22.11.2017,”Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

Miratimin e nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Nisma e ndërmarë do t’i hapë rrugë të gjithë procesit të ndryshimit të PPV, në përputhje të plotë me të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji, duke filluar me:

- a) Analizë të fakteve që çojnë në nevojën për hartimin e ndryshimeve të dokumentave të planifikimit në nivel vendor dhe problemet që do të trajtohen nga ky instrument;
- b) Planin e veprimit në formën e grafikut, për proceset e hartimit e të bashkërendimit, pjesmarrjen apo sipas rastit edhe ndërmjetësimin.

c) Koordinimin mes institucioneve publike dhe alokimin e burimeve njerëzore të nevojshme për hartimin e ndryshimit të dokumenteve të planifikimit në nivel vendor.

- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

